

# KOH

LAJME

KONTAKT



Bottom of Form  
254

## Sot në Xërxë Dita e eksportit, nesër në Krushë Festivali i specit

27 Gusht 2015 - 08:54

*Sot në Xërxë do të organizohet Dita e hapur dhe dita e eksportit, ku do të ketë perime/produkte të varieteteve të reja, të cilat japin rendiment më të mirë, dhe shërbejnë për përpunim, si dhe për eksport.*

Sipas organizatorëve këto produkte janë mbjellë me ndihmën e investimeve të organizatave të huaja siç janë Swisscontacti.

Ky aktivitet organizohet nga AgroCelina, qendër grumbulluese në Xërxë, dhe partner i projektit PPSE, së bashku me drejtorinë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural të Komunës së Gjakovës dhe do të mbahet në fushat e ish-Erenikut, përgjatë rrugës Gjakovë-Prizren. Ceremonia fillon në orën 13:00, ku priten kryetarja e Komunës së Gjakovës dhe kryetari i Komunës së Rahovecit.

Në event janë të ftuar donatorët e projekteve të ndryshme, tregtarët, fermerët dhe të gjitha palët e interesuara. Gjithashtu, do të ketë mundësi të shikohet procesi i vjeljes si demonstrim.

Ndërsa, nesër në Krushë e Madhe të Rahovecit organizohet Festivali i specit, festë kjo e cila organizohet nën patronatin e kryetarit të komunës së Rahovecit, Idriz Vehapi dhe MBPZH-së dhe më përkrahjen e AGRO/USAID.